



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

EKSTRAKTI I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së dytë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, mbajtur më 23.2.2012, e cila filloi në orën 11:00.

Në mbledhje morën pjesë: prof. dr. Isa Mustafa, kryetar i Komunës, Avdullah Hoti, nënkryetar i Komunës, Sami Hamiti, kryesues i Kuvendit, këshilltarët: Hazir Borovci, Shaip Hajrizi, Bekim Gashi, Hetem Kupina, Vjollca Dibra - Ibrahimimi, Rahman Ismajli, Rexhep Mustafa, Avdush Dobratiqi, Premtina Rakovica, Muhamet Nura, Vjollca Rizani, Ajnishahe Azemi, Mustafë Krasniqi, Sarandë Sadriu, Arta Krasniqi, Luan Jusufi, Sali Krasniqi, Tefik Mehmeti, Fetah Salihu, Naime Osmani, Bajram Selimaj, Shefki Uka, Musli Mehaj, Agim Krasniqi, Flamur Shala, Nexhmije Berisha, Aziz Pacolli, Remzi Pacolli, Milazim Vitia, Naim Makolli, Donika Surdulli, Nerxhivane Vitia, Sofije Kllokoqi, Valon Hiseni, Shemsi Veseli, Liridon Restelica, Skënder Reçica, Afërdita Veliu, Besa Halimi – Zagragja, Lumnie Rama, Shefqet Sylejmani, Astrit Hasani, Mejreme Berisha, Shefki Gashi, Besa Rafuna, Kimet Zeqa, Sadri Ramabaja dhe Engin Beyoglu.

Munguan: Meliza Haradinaj dhe Feti Mejdiu.

Morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive, përfaqësues të Ministrisë së Pushtetit Lokal, të OSBE – së dhe të mjeteve të informimit.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Sami Hamiti**, kryesues i Kuvendit.

Kryesuesi fillimisht i njoftoi anëtarët e Kuvendit se janë të obliguar që pranë Agjencionit Antikorrupsion, t'i dorëzojnë formularët e deklaramit të pasurisë. Para se të fillonin me shqyrtimin e pikave të rendit të ditës, **kryesuesi** hapi diskutimin rreth rendit të ditës.

Besa Halimi tha se rendin e ditës e konsideroj të ngarkuar dhe, për hir të shqyrtimit të raportit edhe me pikat tjera të rendit të ditës, është mirë të jetë më i lirë, në mënyrë që të jetë një diskutim më frytdhënës.

U konstatua se njëzëri u miratua ky

REND DITE :

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së parë;
2. Raporti i punës për vitin 2011;
3. Propozimvendimi për plotësimin e Vendimit për emërtimin dhe zyrtarizimin e lagjeve, shesheve dhe rrugëve të komunës së Prishtinës;
4. Propozimvendimi për bartjen e mjeteve nga viti 2011 në vitin 2012;
5. Propozimvendimi për ndryshimin e Rregullores për transparencë;
6. Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të xhamisë në Prishtinë;
7. Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Tregut të kombinuar;
8. Informatë për suksesin e nxënësve në gjysmëvjetorin e parë të vitit shkollor 2011-2012;
9. Pyetje dhe përgjigje;
10. Të ndryshme.

Pika e parë

Sadri Ramabaja bëri vërejtje parimore, duke shtuar se është hera e 2, 3, 10-të, apo se di sa, konform Rregullores së punës së Kuvendit dhe konkretisht pikës 7, do të duhej që në pjesën ku shënohen votuesit, respektivisht ata që janë më pak që votojnë kundër, meqë konfiguracioni i këtij Kuvendi është i tillë, të shënohen emrat dhe mbiemrat e atyre që votojnë kundër.

Kërkoj që të shënohen emrat e atyre që ishin kundër dhe atyre që abstenuan.

Kimet Zeqa bëri vërejtje lidhur me pikën e katërt në ekstrakt, kryesisht rreth ndryshimit dhe plotësimit të Statutit të QMF-së, e cila tha se në vend të emërtimit *Mjekësia Familjare* duhet të jetë *Mjekësia e Punës*.

Vërejtje tjetër kishte rreth moskthimit të përgjigjes, kur kishte kërkuar që në QMF të jetë një psikolog. Lidhur me këtë kërkesë kërkoi përgjigje nga Drejtoria e Shëndetësisë.

Me vërejtjet e dhëna, njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së parë.

Pika e dytë

Lidhur me Raportin e punës për vitin 2011, kryesuesi hapi diskutimin.

Tefik Mehmeti, në emër të GP të LDK-së, tha se raportit i kemi bërë një lexim të vëmendshëm, duke e analizuar dhe shqyrtuar aspektet e përgjithshme dhe të veçanta të tij.

Ky raport prezanton dhe shtjellon në mënyrë të qartë, të strukturuar dhe me kompetencë gjithë rezultatin e arritur gjatë vitit 2011.

Raporti e ka të organizuar informacionin e tillë, që na informon për një formë të tillë të lehtë, të kapshëm dhe të argumentuar, për të gjitha aktivitetet, projektet dhe rezultatet. Një raport që trajton qartë në mes të asaj që është organizuar dhe që është realizuar. Pa dyshim se informacioni, evidencat dhe pasqyrat e qarta e përmbledhëse dhe aktivitetet që janë zhvilluar gjatë një viti, e bëjnë këtë raport të saktë dhe të bindshëm, duke i parë dhe duke i vlerësuar në mënyrë të prekshme të gjitha dinamikat e aktivitetit dhe të arritura në Komunën e Prishtinës. Përmbledhja kryesore është filluar nga buxheti, që lirisht mund të them se për Prishtinën është një buxhet i pamjaftueshëm, këtë e kemi theksuar dhe prapë po e theksojmë, Prishtina ka nevojë për një buxhet më të madh, duke filluar nga granti i përgjithshëm qeveritar, si dhe nga pjesa që i takon. Këtu kisha me e cek edhe marrjen apo zvogëlimin e buxhetit që është bërë për këtë vit, diku rreth 1.500.000 €, që iu kanë dhënë komunave të tjera.

Në bazë të shifrave dhe tabelave, jepet një pasqyrë e qartë mbi të hyrat dhe shpenzimet buxhetore. Shihet se buxheti i vitit 2011 është realizuar

diku rreth 80%, që është një realizim i suksesshëm, kur kemi parasysh aprovimin e buxhetit të vitit 2011.

Duke i marrë parasysh këto vonesa të alokimeve buxhetore, si dhe ato pronësore etj. mund të them lirisht se është realizim i suksesshëm i buxhetit, si dhe shuma e kontraktuar e pashpenzuar është paraparë të bartet në këtë vit për projekte në vazhdim. Elaborimin në këtë raport mund ta bëjmë vetëm në pika të shkurtra, sepse të dhënat konkrete janë të bollshme.

Te Drejtoria e Administratës është për tu përshëndetur qasja për ndërrimin e përqindjes së punëtorëve me përgatitje të lartë shkollore, që duhet të jetë qëllim primar edhe për të ardhmen. Edhe kufizimi i numrit të punëtorëve nga niveli qendror për Komunën e Prishtinës është pengesë në realizimin e punëve në disa shërbime, sepse koha kërkon njerëz të rinj, me përgatitje të lartë kualifikuese.

Edhe drejtoritë tjera, si ajo e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, e Infrastrukturës Lokale, e Arsimit, e Kulturës etj. kanë treguar një rezultat të mirë në realizimin e detyrave të veta.

Bashkëpunimi i Komunës në nivel ndërkombëtar dhe me komunat tjera, ka qenë në nivel shumë të mirë. Kjo rezulton edhe me hapjen e rrugës për donacione shumë të nevojshme nga institucionet e ndryshme ndërkombëtare për përmirësimin e jetës së qytetarëve. Gjithsesi urojmë punë edhe më të mirë në realizimin e objektivave të planifikuara për vitin 2012.

Aziz Pacolli, në emër të GP të AKR-së, tha se këtë raport e kemi lexuar dhe analizuar, megjithatë i kemi disa vërejtje, kërkesa dhe në pika të shkurtra do t'i paraqesim.

Një risi në raportin e punës janë ndërmarrjet publike komunale, ku në pika të shkurtra paraqiten raportet e tyre. Ne kemi kërkuar ndërmarrjet të paraqiten me raporte vjetore në seancat e ardhshme, e mos të jetë në këtë formë, kjo gjysmë faqe raport i punës, kjo është si kërkesë.

Për Termokosin kërkojmë që, së bashku me raport, të na prezantohet edhe projekti i kogjenerimit, pra të njoftohen edhe këshilltarët më gjerësisht rreth atij projekti që është i përfolur kohën e fundit.

Te kompania "Pastrimi", thuhet se është pajisur me disa kamionë dhe kontejnerë të rinj. Lidhur me këtë e kemi një pyetje. Sa është numri i atyre kontejnerëve? Thuhet kompania e ka arritur funksionimin e kapaciteteve të saj sa i përket mbledhjes së mbeturinave urbane. Kisha bërë pyetje: A ka mbeturina urbane e ndërurbane? Për këtë kërkoi sqarim nga drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, që ta bëjë sqarimin e dallimit në mes tyre.

Kërkoi një sqarim nga përfaqësuesi zyrtar i prokurimit, se gjatë vitit 2011 sa tenderë janë anuluar dhe sa kanë shkuar në ritenderim dhe pse është anuluar tenderi i garazheve nëntokësore. Kërkoi nga Drejtoria e Arsimit të sqarohet se çka janë vizitat e përgjithshme, profesionale, vizitat speciale dhe vizitat kthyesë. Vlerësoi se Drejtoria e Ekonomisë është dashtë t'i shënojë emrat se cilat biznese janë stimuluar me mjete financiare. Lidhur me Drejtorinë e Kadastrit pyetje se sa tokë e pauzuruar i ka mbetur Komunës së Prishtinës dhe, nëse ka lirime të tokës, të na tregohet cilat pjesë janë liruuar.

Me këto vërejtje dhe sugjerime, GP i AKR-së e përkrah miratimin e Raportit të punës për vitin 2011.

Skënder Reçica, në emër të GP të PDK-së, tha se me seriozitet e kemi shqyrtuar dhe analizuar Raportin vjetor për vitin 2011, dhe do t'i paraqesim vlerësimet, vërejtjet dhe sugjerimet tona, me qëllimin më të mirë që të merren parasysht në raste kur hartohen raporte të tilla.

Fillimisht potencoi se Administrata e Komunës së Prishtinës në vitin 2011, ka pasur 719 punëtorë dhe në pasqyrën e paraqitur në raport është paraqitur struktura dhe kualifikimet e stafit. Shikuar në përgjithësi, dhe me numër të stafit, administrata e Komunës së Prishtinës realisht duhet të jetë administratë e konsoliduar mirë dhe, normalisht, duhet të ofrojë shërbime cilësore për qytetarët e kësaj komune. Me qëllim të ngritjes së kapacitetit dhe efektit të punës në shërbimet me qytetarë, Komuna duhet të angazhohet edhe më shumë në ngritjen e kapaciteteve profesionale. Janë bërë shumë kërkesa zyrtare të Komitetit për komunitete, gjatë vitit 2011, drejtuar disa sektorëve brenda administratës, dhe asnjëra nga ato nuk është marrë në konsideratë.

Shpenzimet e automjeteve zyrtare të Komunës për vitin 2011, nuk janë të vogla, dhe ky sektor nuk ka dhënë asnjë sqarim në lidhje me përdorimin e tyre. Nuk ka paraqitur asnjë të dhënë në lidhje me koston e mirëmbajtjes së tyre, sigurimin, regjistrimin etj. Prandaj, konstatoj se në lidhje me shpenzimet e automjeteve për vitin 2011, Komuna nuk ka paraqitur pasqyrë reale të koston së shpenzimeve të automjeteve zyrtare.

Drejtorja e Arsimit në raport nuk ka thënë asnjë fjalë të vetme se në çfarë gjendje është arsimi fillor dhe ai i mesëm në shkollat e komunës së Prishtinës. Tabela e paraqitur me të dhëna nga Drejtoria e Urbanizmit, është shumë e paqartë, andaj do të ishte mirë që kjo drejtori të na paraqesë sqarime lidhur me numrin e kërkesave, të lëndëve, të lejeve, sepse në këtë mënyrë si janë paraqitur, krijohet përshtypja se me qëllim është mjegulluar situata lidhur me kërkesat e pranuar dhe ato të trajtuara. Gjithashtu kërkoi nga kjo drejtori, gjegjësisht nga Sektori i legalizimit, që të japë një sqarim se pse ky proces po ecën kaq ngadalë, ku është problemi, a bëhet fjalë për mungesë të kapaciteteve, është ndonjë neglizhencë apo çfarë? Marrë në përgjithësi, ky raport

karacterizohet me një përshkrim të punës dhe aktiviteteve në të gjithë sektorët, por mungon vlerësimi i nivelit të përmbushjes së planit të punës, apo mospërmbushjes së tij, i cili është bazë për zhvillimin e aktiviteteve brenda vitit fiskal, si dhe bazë për hartimin e një raporti pune objektiv, real dhe të besueshëm. Si i tillë prodhon mjegulli dhe huti, krijon përshtypjen se është punuar diçka, e që në esencë kur thellohemi në përmbajtje, e ka vetëm një retorikë boshe, shoqëruar me një jo profesionalizëm dhe hedh dyshim të qëndrueshëm për jo efektivitet dhe jo efikasitet të administratës së Komunës.

Shefqet Sylejmani, në emër të GP të AAK-së, fillimisht tha se është një raport gjithëpërfshirës në konturat e asaj optimales, nuk ka lëvdata të tepërta, herë-herë ka edhe një lloj vetëkritike për ato segmente në të cilat nuk është vepruar sa duhet, për çka ka edhe arsye, dhe jemi plotësisht në pajtueshmëri se problematika e përgjithshme e një centralizimi të paparë të kompetencave në nivelin qendror, dhe pamundësia për marrjen me çështje jetike e kuvendeve të komunave të Kosovës, në përgjithësi edhe të Komunës së Prishtinës, është një prej problemeve thelbësore në punën dhe aktivitetin e secilës prej komunave, dhe kjo është shqetësuese. Konsiderojmë që në këtë drejtim duhet të veprohet shumë shpejtë, në mënyrë që të bëhet decentralizimi i disa prej funksioneve që, tash për tash, në to nuk kanë qasje komunat, pra as kjo e Prishtinës.

Çështja tjetër që konsideroj, nëse ka mundësi ndoshta edhe të bëhet një plotësim në këtë aspekt, në një prej pjesëve të këtij raporti do të ishte mirë që të përfshihej, të cekej problematika e mungesës së Ligjit për Prishtinën, andaj në raport është dashtë që edhe më fuqishëm të dalë në pah kjo çështje.

Çështje tjetër që bie në sy në këtë raport, është se konsiderohet më se e nevojshme që të përmenden edhe disa problematika tjera, që herë-herë ndërliken me ligjet në fuqi, atë të prokurimit p.sh. e dimë cilat janë procedurat e stërzgjatura në këtë sferë të punës.

Përndryshe, raporti në përgjithësi paraqet punën në mënyrë objektive, aktivitetet dhe të arriturat që nuk janë të vogla në aspektin e atyre të ardhurave, p.sh. krijimin e buxhetit etj.

Është për t'u përshëndetur puna dhe angazhimi i përgjithshëm i Kryetarit dhe stafit udhëheqës, gjegjësisht ekzekutivit të Komunës së Prishtinës, edhe në shumë aspekte tjera të punës dhe angazhimit.

Në këtë raport do të duhej paraqitur të gjitha ndërmarrjet publike, në veçanti problematika e Trafikut Urban, çështja e operatorëve ilegalë, çështja e sigurisë publike, gjegjësisht rreth disa problemeve të sigurisë së qytetarëve etj.

Te puna e komiteteve të Kuvendit, konsideroj se do të duhej paraqitur në raportet tona të shkruara.

Për mirëmbajtjen e rrugëve gjatë sezonit të dimrit, gjithashtu është dashtë një raport plotësues nga ajo që paraqitet në raport. Sa i përket vizitave të ndërsjella me shtete fqinje, propozoi që në këto vizita të merrnin pjesë një numër më i madh në delegacione, kryesisht duke i përfshirë edhe anëtarët e Kuvendit.

Urojmë që ky Kuvend, me një qasje shumë serioze, me qëllimet më të mira konstruktive etj. ta ndihmojë punën e përgjithshme të kësaj qeverie dhe të Kryetarit të Komunës, që e përshëndesim dhe përgëzojmë për punën dhe rezultatet e arritura.

Shefki Gashi, në emër të GP të LDD-së, tha se e përkrahim këtë raport në të gjitha informacionet lidhur me punën, aktivitetin dhe takimet e mbajtura të Kryetarit me të gjitha subjektet që i ka pasur, qoftë ndërkombëtare, qofshin vendore, si në aspektin e zhvillimit, administrimit dhe të sigurisë.

Rreth administratës shohim të gjithë se ka përparime, ndryshime, si në pikëpamje teknike, në pikëpamje të shërbimeve etj.

Sa i përket shërbimeve qofshin ato në infrastrukturë, apo investimet e Komunës, mund të them se po anashkalohen disa lagje, andaj ka pozicione të cilat kanë mbetur pa investime me vite të tëra, presim në vitin e ardhshëm, në 2013 ndoshta ato do të plotësohen.

Investimet në Drejtorinë e Arsimit, kryesisht i ka prekur territoret, të cilat kanë qenë më të pambuluara me objekte shkollore, por është d ashtë që në këtë raport të përshkruhen edhe punët e brendshme, si rezultatet e mbërritura të nxënësve në disa gara që marrin pjesë, kryesisht në konkurrencë me të tjerët etj.

Investimet që janë bërë në kuadër të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit, p.sh. ndriçimi i rrugës, ku është kaluar Bunari i Hajratit, TMK-ja, Berishët, lagjet: “Muslijaj”, “Rexhaj” dhe kanë shkuar në Makoc, një lagje atje është ndriçuar, dhe për mua kjo dukuri është si jo e rregullt. Nga Veternikut deri te Hajvalia, është komplet e pandriçuar, një rrugë jashtëzakonisht e ngarkuar.

Te Drejtoria e Kadastrit, mendoj se pronat duhet të legjitimohen dhe të jetë një kontroll më i shtuar ndaj tyre.

Te Drejtoria e Urbanizmi, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, numri i kërkesave, i kushteve urbanistike dhe i dhënies së lejeve nuk korrespondojnë.

Te Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik është dashur të jetë një evidencë, a është punësuar kush, sa vende pune i ka hapur Komuna me ato investime, me ato donacione, p.sh. nëse jepet një investim, donacion që në ndonjë fshat të jepen 4-5 lopë qumështore, aty e ke hapur një vend pune, por duhet me e pas një evidencë se sa ka rritje në atë drejtim.

Në përgjithësi, me këto vërejtje dhe sugjerime, këtë raport e përkrah për miratim.

Kimet Zeqa, në emër të GP të Partisë së Drejtësisë, tha se përkrahim sugjerimet dhe vërejtjet e parafolëse, por problemi më i madh është që nuk ka ligj për Prishtinën dhe në mungesë të këtij ligji, edhe këto probleme janë më të mëdha, andaj dhe raportet nuk janë ashtu si do të dëshironim ne të ishin.

Të dhënat për stafin dhe shërbimet shëndetësore në Komunën e Prishtinës, mendoj se janë në rregull, por, në këtë drejtim, në vitin 2010, doktoresha Nazane Breca që i ka paraqitur disa mjekë specialistë, nuk po përputhen me të dhënat e mia që i kam tashti. Mjekësia familjare ose ligji, po ndryshon si çdo sistem, çdo drejtor që po vjen po i ndryshon këto. Kërkoj që në këtë drejtim të punësohen sa më shumë punëtorë, në veçanti mjekë specialistë, pasi që janë shumë të nevojshëm edhe ndoshta na nevojiten në të ardhmen, kur të hapet edhe Spitali i qytetit, i kemi të gatshëm ndoshta edhe mjekët.

Sadri Ramabaja, në emër të Lëvizjes Vetëvendosje, tha se në raport është bërë përpjekje për të vënë në pah çdo gjë që është bërë, dhe kjo është për tu përshëndetur, por vërehet lehtë përpjekja për ikje nga çdo përgjegjësie për vlerësim real të regresit dhe mospunës,

madje vërehet qartë ikje nga përgjegjësitë politike profesionale në qeverisjen e kryeqendrës.

Ky raport është model për raporte tipike ilustruese, pasqyrë reale e përmbajtjes dhe formës së qeverisjes që e aplikon LDK-ja, sepse e ka një shkollë specifike të qeverisjes që, për mendimin tonë, i takon së kaluarës.

Raporti hedh dritë mbi të gjitha paaftësitë menaxhuese të kësaj force për ta qeverisur qytetin. Dëshmi e mirë për këtë është gjendja kaotike në planin urbanistik, por u pa edhe në menaxhimin e situatave të veçanta, sidomos tash së fundi pas reshjeve.

Raporti hedh dritë edhe në problemet tjera, për të cilat qytetarët kanë pak informacione, por le t'i hedhim një sy vetëm pjesës hyrëse të tij, pa u thelluar në raportin e detajuar të drejtorive përkatëse.

Më shqetësuese për qytetarin është mungesa e zhvillimit ekonomik, respektivisht regresi ekonomik, numri në rritje i të pa punëve, shtohet numri i armatës së të pa punëve me arsim të lartë etj.

Është pak a shumë si punë karikature kjo çka potencohet. Në një vend këtu në këtë raport, tek ndihma që i është dhënë 30 të rinjve për të kryer një praktikë prej disa muajve etj. dhe po të bëhet një krahasim bukur shumë banal, sa janë shpenzuar për nxitjen e të punësuarve të rinj, do të ju rezultojë se më shumë ka kushtuar vetura e drejtorit të ndërmarrjes publike "Pastrimi", sesa të hollat që janë ndarë për rritjen, respektivisht nxitjen e hapjes së vendeve të punës etj.

Do t'i përcjellë edhe me shkrim vërejtjet konkrete, për fusha të veçanta, me shpresë se në raportin e vitit të ardhshëm, një pjesë e ndërgjegjësuar e atyre që do të hartojnë raportin e viti 2012, së paku të mos bëjnë "Copy-Paste" të raporteve paraprake.

Vjollca Dibra shprehu mendimin se në bazë të këtij raporti, shihet qartë se Kryetari, me kabinetin e tij, ka punuar në mënyrë jashtëzakonisht të mirë, duke u ballafaquar me sfida të ndryshme, siç janë: marrja e kompetencave nga niveli qendror, mos ndarja e drejtë buxhetore ndaj Komunës së Prishtinës si kryeqytet i Republikës së Kosovës. Është për t'u lavdëruar që raporti i auditorit për këto vitet e fundit, e nxjerrë Komunën e Prishtinës si një ndër komunat që ka shpenzuar parandë publike në mënyrë të drejtë. Pikërisht ky fakt, në bazë të legjislacionit në fuqi, i mundëson Komunës të marrë kredi nga bankat e huaja, kurdo që e ka të nevojshme. Në këtë raport shihet se Komuna ka arritur t'i arkëtojë 94% të të hyrave vetjake të planifikuara për vitin 2011, të holla të cilat ia kthen qytetarit për investime direkte kapitale. Këto investime mund t'i shoh çdo qytetar, edhe pse dikush nuk dëshiron t'i shoh.

Në bazë të këtij raporti shihet qartë se janë shpenzuar mbi 80% e buxhetit të planifikuar për vitin 2011. Besoj se ky 20%, ka mbetur i pashpenzuar si pasojë e vështirësive që ka hasur Komuna jonë me aprovimin e vonshëm të buxhetit të Kosovës për vitin 2011. Sipas kësaj, të gjitha investimet kapitale janë shtyrë deri në muajt maj-qershor.

Gjithashtu, shihet qartë se bashkëpunimi me donatorët është për lakmi, shihet se shumë projekte janë duke u bashkëfinancuar me donatorë të rëndësishëm, siç janë: KIEV, DEBLU-ja, Komisioni Evropian dhe USAID-i.

Për shkak të mos ndarjes së drejt të buxhetit nga niveli qendror, edhe në vitet në vijim do të ketë shkurtime. Mungesa e Ligjit për Prishtinën dhe disa çështje të tjera, e dëmtojnë në masë Komunën e Prishtinës.

Përkundër të gjitha këtyre sfidave, shihet se në terren është bërë një punë e mirë dhe e kënaqshme.

Besa Halimi vlerësoi se ky raport pune nuk i ka të gjitha të dhënat, të cilat e bëjnë atë profesional dhe analitik dhe nuk mund të themi se kemi përpara një raport serioz të punës. Për shumë mosrealizime hidhet faji në nivelin qendror, pa u ofruar edhe argumentet. Kështu jepen p.sh. numër takimesh dhe vizitash, në vende të ndryshme jashtë vendit, për të treguar punën e Kryetarit, por nuk jepen pastaj rezultatet konkrete të këtyre aktiviteteve, qoftë ato në nivel lokal, me bizneset dhe investitorët lokalë apo ndërkombëtarë.

Pastaj jepet një vërejtje për mosrealizimin e këtyre investimeve kapitale.

Arsyet e dhëna për mos kryerjen e realizimit të investimeve kapitale, nuk janë të bollshme, nuk janë serioze. Nuk është ajo pse nuk është miratuar buxheti, do të duhej të jepeshin edhe disa arsye, të cilat na bindin saktë.

Sa i përket shpërndarjes së padrejtë të buxhetit për investim në arsim nga ana e MASHT-it, e cila gjëja se ka pamundësuar arritjen e standardeve të nevojshme në rritjen e hapësirave mësimore në komunën e Prishtinës dhe diskriminimin, siç është theksuar në raport, për ndarjen buxhetore për këtë komunë, mendoj se nuk është bindëse.

Sa i përket Drejtorisë së Arsimit, mendoj se nuk është bërë një raport serioz i kësaj drejtorie, sepse është bërë pothuajse një përshkrim i detyrave të punës së drejtorisë, pa i treguar aktivitetet e nevojshme dhe pa i analizuar ato. Në raport thuhet se zyrtarët e arsimit kanë pasur një bashkëpunim të mirë me prindër, dhe unë e kam një fakt se në komunën e Prishtinës nuk ekziston as Këshilli i prindërve të këtij qyteti, vite të tëra, konkretisht nga viti 2006, andaj dhe në këtë drejtim nuk është bërë asgjë për ta funksionalizuar, apo për ta iniciuar që të jetë ajo më efektive. Gjithashtu mungojnë të dhëna për disiplinën dhe për rastet delikvente etj. që janë për siguri në shkolla, pra që janë mjaftë të rëndësishme dhe mjaftë të ndjeshme, andaj do të duhej të paraqiteshin qoftë si problematika, qoftë si arritje. Mungojnë të dhëna për laramanitë në suksesin e zbatimit të vendimit për heqjen e kuzhinave nga shkollat, të dhëna rreth mundësisë së ofrimit të shërbimeve shëndetësore për nxënës, si dhe shumë çështje tjera që do duhej domosdo të paraqiteshin në këtë raport.

Shemsi Veseli fillimisht ceku se Kuvendi i Komunës është i thirrur për zgjidhjen e problemeve lokale. Nuk jam ithtar i asaj që të mos kritikohet, por është vendi ku duhet me u kritikuar dhe nuk duhet që ato probleme të rrihen këtu, dhe absolut të jenë tendencioze.

Nuk shpresoj as nuk besoj, me vendimet që janë në nivelin qendror, që ka tendenca Qeveria ndaj Komunës së Prishtinës. Këto vendime janë për të gjitha komunat, siç tha zonja Dibra - Ibrahim, nuk ka të bëjë veç me Prishtinën, ka të bëjë pra me të gjitha komunat.

Problemet lokale janë të shumta dhe është shumë normale që këtu fillon edhe zgjidhja e tyre dhe hallka e parë zinxhirore është pushteti.

Pasqyrimi objektiv i matjes së rezultateve të raportit të punës, për një periudhë kohore, mund të bëhet vetëm nga prerja e detyrave të realizuara në krahasim me ato të planifikuara. Prandaj, çdo mendim sipas treguesve të vëllimit fizik se sa ato apo atij financiar, çdo analizë e tillë meqë mungon, atëherë logjikisht vlerësimi jonë mund të jetë jo profesional, kuturu, mund të jetë tendencioz dhe joserioz, prandaj neve po na imponohet kështu që ne të flasim varësisht prej asaj se sa është realizuar apo nuk është realizuar.

Mendoj që këtij raportit është dashur që t'i bashkëngjitet edhe një raport pune i kryetarit, gjegjësisht raporti është i domosdoshëm në këtë rast, për arsye se projektbuxheti nuk mund të quhet raport pune. Shqetësuese është se asnjë drejtori nuk e sheh të rrugës për me i parë sfidat, vështirësitë, alternativat e mundshme të tejkalimit të atyre, thjesht, nuk i japin objektivat afatshkurta, afatmesme, afatgjata të realizimit të atyre projekteve që i kanë paraparë.

Çështja e ndërmarrjeve publike, konkretisht ngrohtorja "Termokos", në këtë raport nuk përmendet që Qeveria ia ka dhënë 3.000.000 €. Pse mohohet dhe nuk shkruhet kjo e dhënë?! Te promovimi i zhvillimit ekonomik nuk thuhet asnjë fjalë se cilat kanë qenë përfitimet nga këto takime nga bizneset, nëse mund t'i themi këto, pra se ka transparencë dhe të mos ketë asnjë fjalë, janë mbajtur 35 takime dhe mungojnë të dhëna për këto etj. Shqetësuese gjithashtu është edhe paraqitja e raportit të auditorit të brendshëm, andaj dhe kjo të japë të kuptosh se nuk ka ndonjë kontroll të mirëfilltë që ushtrohet në Kuvendin e Komunës së Prishtinës.

Behxhet Musliu, drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, tha se numri i lejeve urbanistike dhe lejeve të ndërtimit asnjëherë nuk mund të jetë i njëjtë, për shkak se leja urbanistike është një procedurë e veçantë për hartim të dokumentacionit, me të cilën investitori pas dy vjetëve mund të paraqitet për leje të ndërtimit, përkatësisht pas katër vjetëve, nëse nuk ka ndryshuar plani.

Sa i përket procedurës së legalizimeve, është punua shumë dhe sigurisht tani është dyfishuar numri, për shkak të një organizimi të përgjithshëm.

Agim Dibrani, drejtor i Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik, tha se kjo drejtori disponon me dokumentacion për donacionet që janë dhënë për vitin 2011. Kanë qenë diku rreth 500 përfitues, në shumë prej rreth 447.000 €, pra kemi angazhuar rreth 500 familje qoftë me ndihma për mbjellje pranverore, qoftë me sera, qoftë në përfitime në bashkëpunim me AJFER-in, është një numër jo aq i kënaqshëm, megjithatë numri 500 do të thotë shumë.

Shiqeri Spahiu, drejtor i Drejtorisë së Kadastrit, tha se Drejtoria e Kadastrit nuk mban evidenca për tokat të cilat janë të uzurpuara. Drejtoria e Kadastrit mban evidencën e të gjitha pasurive të paluajtshme në regjistrin e së drejtës së pronës dhe bën azhurimin e tyre sipas kërkesës dhe sipas transaksioneve.

Sa i përket punësimit të dy punëtorëve vendorë dhe një ndërkombëtar, ata janë në kudër të projektit të DGIZ-së, bashkëpunimi gjerman ndërkombëtar që është si donator i Agjencionit Kadastral të Kosovës për realizimin e projektit për menaxhimin e tokës së Kosovës, në kuadër të të cilit edhe Komuna e Prishtinës është përfituese e këtij projekti. Caktimin e tyre dhe pagat e tyre, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e bënë DGIZ-ja e jo Komuna e Prishtinës, por ata punojnë aty për Komunën e Prishtinës.

Halim Halimi, drejtor i Drejtorisë së Arsimit, tha se mbikëqyrja profesionale në shkolla është kompetencë e drejtpërdrejtë e Ministrisë së Arsimit.

Deri tash mbikëqyrja profesionale në shkollat tona nga ana e Ministrisë ka ngecur shumë, tash gëzon fakti se kjo ministri ka formuar Inspektoratin e arsimit, mirëpo veç sa kanë filluar. Mendoj se ky inspektorat duhet të ketë kapacitet më të madh, numër më të madh të punonjësve, ngase vizitat i bëjnë në kuadër të rajonit, kështu që në komunën e Prishtinës kanë bërë shumë pak vizita profesionale.

Sa i përket vizitave profesionale, tha se ato parashohin planin e punës të zyrtarëve arsimorë dhe ato vizita nuk janë në kompetencë të nivelit komunal. Shumë çështje varen nga niveli qendror dhe nuk janë në kompetencë të nivelit lokal.

Sa i përket Drejtorisë së Administratës, kjo drejtori ka investuar shumë në stafin civil, ka organizuar trajnime, por edhe është bërë edhe pranimi i punëtorëve të rinj. Në sportelet e Komunës së Prishtinës më nuk ka radhë të qytetarëve, nuk ka pritje, që nënkupton se kemi një administratë efikase, kryhen punët me efikasitet, edhe pse gjithmonë ka vend për përmirësime.

Agim Gashi, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit, tha se kompania "Pastrimi" nga buxheti i Komunës është furnizuar me 250 kontejnerë, dhe 100 të tjerë donacion nga GIZ-ja.

Sa i përket lotove të mirëmbajtjeve verore ose dimërore, ndoshta aty do të kishte qenë më mirë që ne ta paraqesim me sipërfaqe të m², sepse ato 86 rrugë përfshijnë sipërfaqe shumë më të madhe se sa 117 rrugë.

Sa i përket ndriçimit, projektet që i kemi filluar vitin e kaluar, janë në fazën e parë dhe do t'i vazhdojmë në vitin 2012, të gjitha ato pjesë vendbanimesh të dendura që janë përreth Prishtinës dhe do të kompletohen, kurse për ndriçimin e rrugës nga Veterniku në drejtim të Hajvalisë është kompetente Ministria e Transportit.

Ekrem Rexha, shef i Zyrës së prokurimit, paraqiti arsyeshmërinë rreth anulimit të tenderit për ndërtimin e garazheve nëntokësore përmes partneritetit publiko-privat. Lidhur me këtë shtoi se të gjitha ofertat, me përjashtim të rastit të Fakulteti Filologjik, kanë devijuar prej detyrës projektuese. Pra, përveç pjesës së poshtme që e kanë projektuar mirë për ndërtim të garazheve, në pjesën e sipërme kanë bërë devijim, duke favorizuar tepër ndërtimin e objekteve afariste.

Jemi në përpunim të procedurave të reja. Tash, me ndryshimin e Ligjit për partneritet publiko-privat, i cili ka kaluar, do të përsëriten tenderët për këto 3 projekte.

Prof.dr. Isa Mustafa, Kryetar, tha se të gjitha diskutimet i konsideroj të mirëseardhura dhe mirëdashëse, sepse ato i orientojnë edhe drejtoritë, por edhe mua si Kryetar të Komunës, në çështjet që ju i hapni para nesh, të cilat i konsideroni me prioritet të veçantë. Mund t'ju them se në këtë vit ne i kemi pasur disa prej prioritetëve, që i kemi vazhduar nga vitet e mëparme. Ende vazhdojmë t'i trajtojmë me prioritet projektet e infrastrukturës, sepse e kemi trashëguar një nivel shumë të pakënaqshëm të rrugëve, të trotuareve, të infrastrukturës së kanalizimit etj.

Në këtë aspekt kemi arritur rezultate të mira, meqë disa lagje që i kemi pasur në gjendje të rëndë, siç janë lagjet "Kodra e Trimave", "Fusha e Pajtit" dhe disa fshatra në pjesën e Gollaku dhe të Llapit.

Kemi orientuar investimet tona në ndërtimin e shkollave, ku kemi arritur ta zvogëlojmë numrin e ndërresave të nxënësve dhe tani kemi vetëm dy ndërresa. Kemi pranuar punëtor të rinj, kemi investuar në ngritje dhe rregullimin e sporteve, në mënyrë që qytetarëve të ju sigurojmë kushte më të mira dhe komunikim më transparent.

Jemi përqendruar në investime strategjike me mjete nga donatorët e jashtëm, si për fabrikën e ujit dhe për ngrohtoren e qytetit, konkretisht për kogjenerim.

Për të gjitha sugjerimet e dhëna, do të bëjmë përpjekje maksimale për realizimin e projekteve të parapara dhe orientimin e mjeteve do ta përqendrojmë si për investimet në qytet, ashtu edhe në pjesën rurale.

Me shumicë votash, pesë kundër (Shemsi Veseli, Besa Halimi, Sadri Ramabaja, Skënder Reçica dhe Lumnije Rama), u miratua Raporti i punës për vitin 2011.

Pika e tretë

Lidhur me Propozimvendimin për plotësimin e Vendimit për emërtimin dhe zyrtarizmin e lagjeve, shesheve dhe rrugëve të komunës së Prishtinës, kryesuesi hapi diskutimin.

Vjollca Dibra, në emër të GP të LDK-së dhe në cilësinë e anëtarit të Komisionit për emërtimin e rrugëve, tha se komisioni fillimisht ka hartuar kriteret për emërtimin e rrugëve dhe këto kriteret janë miratuar njëzëri dhe është marrë vendim që kërkesat e qytetarëve për ndryshimin e emërimit të rrugëve të vitit 2001 të mos merren parasysh, për faktin që komisioni ka qenë i mandatuar vetëm për emërtimin e rrugëve të reja.

Personalitetet sipas të cilave rrugët dhe vendet publike kanë marrë emërtimet, janë të karakterit komunal, rajonal, kombëtar dhe ndërkombëtar nga të gjitha fushat e lartpërmendura. Janë emrat e personaliteteve të personave të ndjerë, gjegjësisht të personave që nuk janë në jetë, është marrë për bazë kontributi i gjithanshëm i personaliteteve nga e kaluara historike, kultura, arsimit, shkenca veprimtaria humanitare, si dhe veprimtaria politike kombëtare.

Përveç personaliteteve nga fushat e ndryshme, në listë janë përfshirë edhe emra me toponime gjeografike, për të cilat kemi menduar se është shumë e qëlluar.

Ky komision ka shqyrtuar të gjitha kërkesat dhe ankesat e qytetarëve, prej të cilave shumica janë miratuar, përveç atyre që kanë rënë ndesh me kriteret.

Një propozim tjetër që vjen nga komisioni, por edhe nga Grupi parlamentar i LDK-së, është që rruga "Kosova", në fakt aty ku është rruga "UÇK", është një rrugë shumë e shkurtër me këtë emër dhe propozuam që të hiqet ky emërtim, dhe ky emër "Kosova" në të ardhmen të jetë diku në një rrugë më të gjatë ose në një rrugë më me peshë.

Komisioni ka propozuar që rruga "Vëllezërit Gërvalla" të emërtohet rruga "Bardhosh Gërvalla".

Naim Makolli, në emër të GP të AKR-së tha se e kemi shqyrtuar këtë listë të emrave për nominimin e rrugëve të reja të Prishtinës dhe ndjehemi krenar edhe ne që me emërtimin e rrugëve të reja, kemi mundësi të nderojmë figura dhe personalitete të ndritura të historisë sonë kombëtare dhe më gjerë.

Megjithatë, kam një vërejtje më të përgjithësuar, sidomos po lidhem me toponimet gjeografike. Në tërë këtë listë, me njëqind e sa rrugëve që janë, nuk

kemi pothuajse asnjë me emërime nga pjesa e Toplicës. Këtë emër vetëm e kujtojmë në bazë të mbiemrave që i mbanë popullata e larguar nga ajo pjesë, mirëpo e kemi një pjesë të harruar, andaj do të ishte mirë që krahas disa emërtimeve, siç janë: "Gjakova", "Tropoja", "Tetova" e shumë e shumë të tjera, të kishin zënë vend disa toponime, disa emërime nga këto trevat e Toplicës. Do të kishte qenë shumë më mirë sikur të ishte rruga "Bllaca", rruga "Restelica", rruga "Vllasaj", rruga "Ramabaja" dhe shumë rrugë të tjera.

Gjithashtu propozoi që një nga rrugët e qytetit të mbajë emrin e ish-këshillëtarit të Kuvendit të Komunës, pra rruga "Arif Krasniqi".

Shemi Veseli tha se edhe ne si GP i PDK-së, e kemi diskutuar dhe analizuar këtë propozimvendim dhe konsideroj që është një e metë, sepse komisioni nuk na ka ofruar një biografi të shkurtër për secilin propozim të dhënë.

Emërtimi i rrugëve është një çështje delikate dhe me peshë jo vetëm politike, d.m.th. ato emërime duhet t'i rezistojnë kohërave, dhe meqë duhet t'i rezistojnë, ne nuk duhet të dalim para një sfide që çdo 2-3 vjet të ndërrohen këto emërtime. Unë konsideroj që është një lëshim nga ana e komisionit, sepse është dashur t'i bashkëngjitet çdo propozimi 5-6 fjali për të kaluarën e tyre, megjithatë unë shpresoj dhe besoj që, në një të ardhme ndoshta jo të largët, do të bëhet edhe një analizë e thukët për të gjitha emërimet e rrugëve që janë në komunën e Prishtinës, duke pasur për bazë edhe emërimet e reja.

Shefqet Sylejmani, në emër të GP të AAK-së, përgëzoi komisionin për këtë punë aspak të lehtë. Në frymën e kësaj, grupi ynë parlamentar propozon që të gjendet një rrugë, një vend, për emrin e të nderuarit dhe të ndjerit prof. dr. Ali Zatriqi, doktor i shkencave të mjekësisë.

Gjithashtu, për hir të mundësisë më të lehtë të gjetjes së rrugëve, propozoj që rrugët të shënohen edhe me numra. Shembull konkret merr lagjen "Tophane", e cila është njëra prej lagjeve më të vjetra të Prishtinës, të shënohet me numrin 1 dhe të vazhdojë kështu më tutje. Mendoj se kjo do ta lehtësonte shumë gjindshmërinë e njerëzve jo vetëm të huajve, jo vetëm të qytetarëve tjerë të Kosovës, por edhe vetë prishtinasve, sepse është rritur Prishtina dhe është e shkapërderdhur kjo strukturë e emërtimeve dhe është bukur vështir të gjendet. Ky është një propozim për perspektivë, por për të ardhmen të mendohet për këtë iniciativë.

E përkrahim në tërësi për miratim këtë listë me këto propozime.

Shefki Gashi, në emër të GP të LDD-së dhe në cilësinë e anëtarit të Komisionit për emërtimin e rrugëve, fillimisht tha se ka qenë kënaqësi me punuar në një komision të tillë, por e vetmja e metë ka qenë që nuk kemi pasur ndihmë prej

institucioneve, qofshin prej partive politike, qofshin prej institucioneve komunale, qofshin prej institucioneve të shkencës, artit, kulturës, luftës etj., me përjashtim të Shoqatave të Luftës, që na e kanë dërguar një regjistër të njerëzve meritore. Kemi pasur mjaftë probleme rreth caktimit të kriterëve të përparësisë për radhitjen e njerëzve sipas meritave që kanë në rrjedhat e përgjithshme të Kosovës.

Përveç kësaj, kemi bërë emërtimet e rrugëve edhe me toponime të territoreve etnike shqiptare, me personalitetet të merituar të luftës, të kulturës, të artit, të shkencës, të filmit, të muzikës, çfarëdo qofshin ata. Përkundër gjithë asaj që është propozuar dhe janë përfshirë në listën përfundimtare, mungojnë disa nga propozimet e dhëna për emërtimin e disa rrugëve, si rruga “Xhemail Mustafa” dhe rruga “Xhemail Hyseni” dhe kërkoj që këta emra të kthehen në listën përfundimtare.

Jemi përpjekur që ti përfshijmë propozimet e të gjithë njerëzve, jo vetëm të individëve ose grupeve politike ose dikujt tjetër, andaj ju ftoj që unanimisht ta miratojmë këtë listë.

Kimet Zeqa, në emër të GP të Partisë së Drejtësisë, e përshëndeti komisionin për këtë punë mjaft të vështirë dhe përkrahu diskutimet e parafolësve, me dëshirën që, në një të ardhme sa më të afërt, edhe Partia e Drejtësisë të propozojë ndonjërin që është medituës.

Sadri Ramabaja, në emër të Lëvizjes Vetëvendosje, tha se po miratojmë një listë që në fakt do të krijojë një identitet të ri për kryeqendrën tonë, për një pjesë të kryeqendrës sonë, së paku pra për rrugët e reja, zgjerimin e qytetit etj. Kam para sysh që ky komision ka pasur jashtëzakonisht shumë punë, por kam parasysh edhe një diçka tjetër, që ky komision në përbërje ka pas edhe dy historianë. Janë disa lëshime, për të cilat kanë tërhequr vërejtjen me plotë meritë edhe media, siç është emërtimi i një rruge me emrin e shkrimtarit Zejnullah Halili. Emërtimi i një rrugice me emrin e tij nuk na nderon aspak, përkundrazi, nuk është e dinjitetshme, madje shumë më mirë do të ishte që të pagëzohet ndonjë shkollë fillore. Një pjesë e emrave që janë potencuar këtu, janë vazhdimësi e shkollës politike jugosllave që nuk e nderojnë kryeqendrën tonë, siç janë: Fadil Hoxha, Mahmut Bakalli, Nebih Gashin etj. Në këtë listë është vetëm një emër i qytetit tonë në Kosovën Lindore, është fjala për Medvegjen, madje edhe varianti sllav Medvegja.

Kisha propozuar që të kihet parasysh, që në këtë listë të përfshihen edhe emra prej Toplicës, Nishit, Leskocit, Vrajës etj.

Do të ishte në nderin tonë që ta kemi një emër me emrin rruga “Leskoci”. Të dhënat historike sllave dëshmojnë se në vitin 1933, Leskoci ka pasur mbi 60% të popullsisë shqiptare dhe ka qenë burim i kryengritjeve të para për krijimin e shtetit modern shqiptar. Në vitin 1833, njëri prej udhëheqësve kryesor të gjeneralëve të atëhershëm, Sylejman Vraja, ka qenë udhëheqës i kësaj kryengritje. Emërtimi i një rruge me emrin e këtij gjenerali do të ishte në nderin tonë dhe të kryeqendrës; pse jo edhe me emra si: Vraja, Presheva, Molla e Kuqe, që është simbol i jashtëzakonshëm për pjesën dërmuese këtu.

Uroj që këto sugjerime të merren në frymën e konstruktivitetit, sepse kemi të bëjmë me krijimin e identitetit të ri të qytetit tonë.

Mejreme Berisha tha se kamë kërkuar që kjo listë të ketë edhe emra të dëshmorëve nga lufta e fundit e Ushtrisë Çlirimtare nga të gjitha trevat tona, nga Mali i Zi, ku kemi dëshmorin Triumf Dedushi, i cili ka ardhur prej Amerikës dhe ka rënë dëshmor në Koshare, nga Maqedonia kemi Muhedin Aliun, djali i vetëm i familjes, i cili ka rënë heroikisht në Kosovë dhe shumë dëshmorë nga Shqipëria.

Sa i përket artit, kulturës, historisë, qyteteve etj. nuk do të duhej harruar as abreshët e Italisë, le ta marrin Vorea Ujkon, i cili është njëri ndër abreshët që deri në momentin e fundit i ka rrahur zemra për këtë vend, kemi abreshët e Zarës, siç ishte Shime Deshpali, një figurë madhore. Mungojnë emrat e qyteteve si Ulqini, Tivari, si vende të kulturës shqiptare etj.

Kërkoj që këto gjëra komisioni t'i marrë parasysh dhe me këto propozime ta plotësoj këtë listë.

Milazim Vitija tha se komisioni iu ka sugjeruar të gjitha grupeve parlamentare që të sjellin dhe të propozojnë sa më shumë emra, në mënyrë që këto rrugë të emërtohen me emra meritore.

Shumica e vërejtjeve qëndrojnë, mirëpo keni parasysh se shumica e emrave të propozuar tani, janë të vënë nga komisioni i mëparshëm, siç janë rrugët: "Presheva", "Ulqini", "Tivari", e shumë të tjera.

Të gjitha këto vërejtje dhe sugjerime që u dhanë, në vazhdimësi do t'i përpunojmë dhe do të shohim më tutje.

Besa Halimi, në cilësinë e anëtares së Komisionit për emërtimin e rrugëve, bëri vërejtje, duke thënë se si anëtare e komisionit 2-3 mbledhjet e para nuk kam qenë e pranishme për arsye se nuk kam qenë e informuar, por, si do që të jetë, është bërë një punë e mirë dhe është punuar në bazë të kriterëve që janë paraparë.

Si anëtare e komisionit, kam kërkuar me këmbëngulje që të bëhet përkrahimi me 4-5 rreshta për secilin emër të propozuar. Kërkoj nga ky kuvend që t'i japë të drejtë propozimit tim dhe ta kthej këtë obligim tek ky komision, për ta plotësuar këtë listë me sado pak të dhëna për secilin propozim, qoftë toponimik, qoftë emër kulture, historie a fushe tjetër, dhe më pas kjo listë të shikohet nga Kuvendi, me qëllim që të jetë më e qëndrueshme në një kohë më të gjatë.

Fillimisht kemi tentuar që rrugët të jenë më tepër me shifra ose shkronja, ashtu siç janë në shumë vende të Evropës. Kjo është për çështje praktike të gjendjes së qytetarëve vendas dhe të huaj.

Pas propozimeve të qytetarëve dhe të disa anëtarëve të komisionit, na është imponuar ndryshimi i atij qëndrimi. Sido që të jetë, lista është bërë, e kemi miratuar dhe në mbledhjen e fundit të këtij komisioni, kjo listë nuk e ka pas këtë numër të propozimeve që e kemi sot këtu në Kuvend.

Në këtë listë janë bërë ndryshime, të cilat ne nuk i kemi miratuar në atë komision. Komisioni e ka miratuar emrin e Ramush Ramës dhe tash nuk figuron në listë. Parimisht, sipas disa kriterëve, nuk jemi pajtuar me propozimin e disa anëtarëve të komisionit për përfshirjen e disa emrave në këtë listë etj. Gjatë punës së komisionit ka pasur disa paqartësi, për të cilat është mirë të definohen saktë dhe të qartësohen, në mënyrë që të jemi sa më korrekt.

Me shumicë votash, një kundër (Sadri Ramabaja) dhe një abstenim (Luan Jusufi), u miratua Vendimi për plotësimin e Vendimit për emërtimin dhe zyrtarizimin e lagjeve, shesheve dhe rrugëve të komunës së Prishtinës.

Pika e katërt

Lidhur me Propozimvendimi për bartjen e mjeteve nga viti 2011 në vitin 2012, Xhelil Bektashi, drejtor i Drejtorisë për Financa dhe Pronë, në pika të shkurtra paraqiti arsyeshmërinë për bartje e mjeteve.

Tefik Mehmeti në emër të GP të LDK-së, tha se për shkak të projekteve madhore apo projekteve shumëvjeçare, do të kemi gjithherë bartje të mjeteve nga viti në vit. Janë disa faktor që ndikojnë në bartje të mjeteve, andaj dhe lejohen këto bartje. Grupi i këshilltarëve të LDK-së, pajtohet me këtë bartje të mjeteve, kur dihet se shumica e tyre, diku 52%, janë për investime kapitale.

Aziz Pacolli në emër të GP të AKR-së, tha se deshëm apo nuk deshëm, këto mjete kanë mbetur, andaj më mirë është që t'i pranojmë bartjet për këtë vit.

Skënder Reçica, në emër të GP të PDK-së, tha se në parim e mbështesim këtë propozimvendim për bartjen e mjeteve, sepse këtë e lejon Ligji mbi menaxhimin e financave publike. Konsiderojmë se këtij vendimi i mungon arsyetimi i mirëfilltë nga drejtoria përkatëse, dhe për këtë kërkojmë që të jetë një informacion më i zgjeruar rreth projekteve.

Disa prej projekteve, siç janë: sheshi "Zahir Pajaziti" dhe sheshi "Ibrahim Rugova", iu mungon koha e fillimit të projektit, shuma e paguar apo e shpenzuar në vitin 2011 dhe shuma e mbetur. Lidhur me këtë pyes se a ka mundësi që këto projekte të planifikohen si duhet në të ardhmen, dhe nëse po, a ka mundësi që projektet e tilla në të ardhmen të planifikohen në faza investuese, në dy vite fiskale, nëse nuk mund të realizohen brenda një viti fiskal?

Shefqet Sylejmani, në emër të GP të AAK-së, sugjeroi që materialet e tilla kur të paraqiten për shqyrtim, do të ishte mirë që arsyetimi të jetë më i plotë, në mënyrë që të bëhet e qartë për çka barten këto mjete prej vitit në vit.

Me sugjerimin e dhënë, e përkrahim këtë propozimvendim për miratim.

Shefki Gashi, në emër të GP të LDD-së, shprehu mendimin se kur të bëhet planifikimi i projekteve, do të duhej analizuar mirë se a mund të realizohet ai projekt për aq kohë sa është llogaritur, duhet të merren parasysh disa kushte dhe rrethana, problemet rreth çështjeve kontestimore të pronave etj. të cilat bëjnë që këto projekte të shtyhen për realizim vitin e ardhshëm.

Kimet Zeqa, në emër të GP të Partisë së Drejtësisë, tha se kam një dilemë rreth projekteve të ndërtimit të QMF-së 1 në Prishtinë dhe të morgut, sepse në vitin e kaluar këto mjetet për këto projekte janë alokuar në QMF-në 4, ku është veç duke u ndërtuar. Ajo kërkoi sqarim lidhur me këto projekte.

Gjithashtu kërkoi që Drejtoria e Shëndetësisë të marrë masa rreth të hyrave në shëndetësi, që të interesohet në Departamentin e prokurimit, se kjo drejtori a ka nevojë për orë shtesë jashtë orarit të punës.

Sadri Ramabaja, në emër të Lëvizjes Vetëvendosje, shprehu shqetësim se në politikat financiare, kur të bëhen propozimet e kësaj natyre për bartjen e mjeteve nga viti në vit, është krijuar një mundësi e mirë që të gjinden alibitë e fuqishme për të mbuluar deficitin, respektivisht paaftësinë për të qeverisur me paratë publike. Jemi dëshmitarë se kjo lojë ka vazhduar edhe këtë vit relativisht më shumë, madje bëhet fjalë për shumë miliona euro, ku shumica e këtyre mjeteve po barten për dy sheshe, që lenë jashtëzakonisht shumë për të dyshuar se si po menaxhohen financat përgjithësisht.

Meqë ligji e garanton bartjen, ne nuk jemi kundër, por ky kapital kaq i madh të përdoret për dy sheshe, në këtë kohë kur mbi 45% janë në buzë të varfërisë, për neve është e tepërt, andaj dhe kjo është arsyeja që un abstenoj.

Me shumicë absolute votash, një abstenim (Sadri Ramabaja), u miratua Vendimi për bartjen e mjeteve nga viti 2011 në vitin 2012.

Pika e pestë

Lidhur me Propozimvendimin për ndryshimin e Rregullores për transparencë, Kryesuesi tha se është një kërkesë që vjen nga MAPL – ja dhe Ombduspersioni për KPF-në, se a është e hapur apo e mbyllur për publikun.

Shemsi Veseli tha se është për ta falënderuar edhe INPO-në që ka qenë njëra prej organizatave joqeveritare që e ka iniciuar këtë, pra ka qenë një lloj promotori, andaj e përkrahu këtë propozimvendim.

Njëzëri u miratua Vendimi për ndryshimin e Rregullores për transparencë.

Pika e gjashtë

Me shumicë absolute votash, një abstenim (Sadri Ramabaja) u miratua Vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të xhamisë në Prishtinë.

Pika e shtatë

Lidhur me Propozimvendimin për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Tregut të kombinuar, arsyetimin për këtë propozimvendim e paraqiti Agim Gashi.

Aziz Pacolli, në emër të GP të AKR-së, tha se kanë qenë të ndarë për tregun e kombinuar rreth 15 ha, e tash janë 2 hektar të punuar. Kjo gjithashtu është kërkesë edhe e qytetarëve dhe kur do të kompletohet ajo pjesë?

Njëzëri u miratua Vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Tregut të kombinuar.

Pika e tetë

Për Informatë për suksesin e nxënësve në gjysmëvjetorin e parë të vitit shkollor 2011 - 2012, të pranishmit i informoi Halim Halimi, drejtor i Drejtorisë së Arsimit, i cili tha se me këtë informatë e kemi bërë një krahasim të suksesit dhe vijueshmërisë së nxënësve gjatë këtij viti në krahasim me atë të vitit të kaluar. Me këtë informatë kemi përcjellë edhe të dhënat rreth faktorëve, të cilët kanë ndikuar në suksesin apo në mos suksesin e këtyre nxënësve.

Për një vlerësim të tillë komunat nuk kanë kapacitete, por, siç thash edhe më parë, ajo është detyrë e Ministrisë së Arsimit, përkatësisht e Inspektoratit të Arsimit, të cilët bëjnë vlerësimin e nxënësve, por ndoshta edhe vlerësimin e arsimtarëve që punojnë në procesin arsimor. Ne nuk jemi ndalur në analizimin e faktorëve që ndikojnë në suksesin apo mos suksesin e nxënësve. Kjo informatë është hartuar në bazë të shënimeve, të cilat i kanë dërguar shkollat.

Ajnishahe Azemi vlerësoi informatën si të hartuar shumë mirë, e cila ofron informata të mjaftueshme për suksesin e nxënësve të arritur në procesin edukativo-arsimor në të gjitha shkollat fillore dhe të mesme të komunës së Prishtinës. Kjo informatë paraqet edhe gjendjen reale të suksesit në shkollat tona.

Në bazë të treguesve statistikorë dhe sasiorë në këtë informatë, rezulton se sukcesi në gjysmëvjetorin e parë është i kënaqshëm, posaçërisht në nivelin e parë, klasa e parë deri në të pestën dhe në nivelin e dytë, klasa e gjashtë deri në të nëntën. Kjo aq më parë kur sukcesi në gjysmëvjetorin e parë karakterizohet me një vlerësim më real sesa në gjysmëvjetorin e dytë.

Besa Halimi shprehu mospajtim ndaj diskutimit të drejtorit të drejtorisë, duke shtuar se nuk e di se cilat kompetenca po i mbeten Drejtorisë së Arsimit, nëse as analiza e tabelave dhe shifrave lidhur me suksesin e niveleve të arsimit parauniversitar nuk i mbetet kësaj drejtorie. Inspektorati e ka një pjesë të vetën, por çka atëherë po mbetet për drejtorinë. Përderisa mbikëqyrja e detyrave të punës e të gjitha shkollave të niveleve të arsimit parauniversitare është në kompetencë të Drejtorisë së Arsimit, është dashtë që kjo drejtori ta bëjë edhe një analizë të suksesit të nxënësve. Nëse konstatohet se sukcesi në nivelin fillor është i ulët, apo i fryrë, atëherë duhet të gjenden arsyt pse është i tillë. Nëse konstatojmë se mungesat janë shumë të mëdha, vijueshmëri jo të kënaqshme të mësimdhënësve, duhet gjetur arsyt pse ato janë evidente.

Gjithashtu, tabelës së të dhënave për suksesin e fundvitit duhet t'i shtohet edhe rubrika për ata të cilët e kanë lëshuar shkollën, që të mos kemi huti për kësi lloj shifrash.

Për këtë informatë ka shumë për tu diskutuar, që do të thotë se nuk është bërë asnjë analizë e mirëfilltë. Janë shifra të thata, të cilat do të duhej t'i studionte kjo drejtori.

Aziz Pacolli tha se këto çështje dhe probleme të arsimit parauniversitar i kemi shqyrtuar dhe analizuar edhe më herët, por kërkoi të dijë se cili inspektion, apo te

cili nivel lokal ose qendror është kontrollimi i punës së profesorëve. Aty është komplet esenca e suksesit të nxënësve.

Ndaj këtyre personave do të kisha qenë shumë rigoroz, jo vetëm si këshilltar apo si drejtor komunal, por vërtet është e rrugës që në këtë drejtim të bëhet një koordinimi i punëve mes nivelit lokal, dhe atij qendror dhe të bëjnë kontrollimin e punës së arsimtarëve nëpër shkolla. Përveç vlerësimit të nxënësve, domosdo do të duhej të vlerësohej edhe personeli arsimor.

Mejreme Berisha shprehu brengosjen e saj, duke pasur parasysh se është e lidhur me procesin mësimor dhe sheh drejtpërdrejt situatën e mjerë në arsim.

Shprehu mendimin se nuk mund të arsyetohet as niveli lokal e as ai qendror, derisa një paralele në gjimnaz i ka 50 apo 47 nxënës. Si mund të udhëhiqet një orë mësimi dhe të bëhet vlerësim real i nxënësve në këto kushte?! Esenca e kësaj është se çka duhet të bëjmë më tutje me bazën e arsimit në gjithë Kosovën, e jo vetëm në komunën tonë.

Sadri Ramabaja tha se, duke pasur parasysh diskutimet e paraqitura rreth kësaj informate, shihet se ky diskutim nuk është përmbajtjesor për tragjedinë që po luhet me shkollën tonë, për fatin e keq se në çfarë pozicioni ka rënë shkolla jonë. Apeloj që t'i rezervohet kohë më shumë trajtimit të kësaj çështjeje, në mënyrë që të kërkohet zgjidhje për dalje nga situata që është krijuar.

Shifrat e dhëna në këtë informatë, kryesisht rreth suksesit, janë alarmante, andaj kësaj pike duhet t'i kushtojmë rëndësi më shumë në një mbledhje pasuese për të gjetur rrugëzgjidhje, e jo për të kaluar situatën kështu si është si informatë.

Çështjes së cilësisë në shkollë duhet t'i kushtojmë një pikë të veçantë dhe të jetë nga pikat e para, e jo në pikën e fundit.

Njëzëri u përkrah Informata për suksesin e nxënësve në gjysmëvjetorin e parë të vitit shkollor 2011 – 2012.

**Pika e nëntë dhe e dhjetë
Pyetje, përgjigje dhe të ndryshme**

Rrahman Ismajli ngriti shqetësim për moskthimin e përgjigjeve nga ana e drejtorive, me ç'rast tha se në mbledhjen e parafundit kam bërë disa pyetje dhe nuk kam marrë përgjigje. Për pyetjet e parashtruara kërkoj që të jepen përgjigjet me shkrim.

Lidhur me mosdhënien e përgjigjeve nga ana e ekzekutivit, Kryesuesi kërkoi nga drejtorët e drejtorive, që të jenë sa më korrekt për kthimin e përgjigjeve që parashtruara.

Astrit Hasani parashtrroi pyetje, duke thënë se para një viti është miratuar shujta për punëtorët e Komunës së Prishtinës, dhe më intereson se a kanë marrë ndonjëherë shujtë punëtorët e Komunës, nëse jo, atëherë për çfarë arsye nuk është realizuar kjo dhe ku është problemi.

Për mosrealizimin e shujtës për punëtorët e Komunës, Kryesuesi dha sqarime të nevojshme.

Naime Osmani parashtrroi pyetje për Drejtorinë e Shërbimeve Publike.

A ka leje kjo drejtori për eliminimin e qenve endacakë, nëse ka leje, atëherë kërkoj që të ndërmerr masa për eliminimin e tyre, pasi që paraqesin rrezik, sidomos për fëmijë?

Lidhur me pyetjen e parashtruar, **Agim Gashi** tha se për eliminimin e qenve endacakë, pritet edhe pak ditë për të lidhur kontratë me kompaninë që e ka fituar tenderin për trajtimin e qenve endacakë, jo vrasjen e tyre, por do të bëhet kastrimi dhe sterilizimi i tyre.

Sadri Ramabaja tha se në mbledhjen e kaluar shtrova një pyetje, pasi që kryesia e Lëvizjes Vetëvendosje nuk kishte marrë përgjigje nga niveli qendror për kërkesën që ka bërë me shkrim për hapësirën për ndërtimin e selisë. Kjo ishte kompetencë e Komunës, sipas informatave që mora unë. Ata që tre muaj e kanë bërë kërkesën me shkrim dhe nuk kanë marrë përgjigje.

Kryesuesi tha se në momentin që do të vije një kërkesë e tillë, përgjigjja do të jepet në suaza të ligjit.

Mejreme Berisha parashtroi pyetje për kryesuesin e Kuvendit.

Z. kryesues, sa ndan buxhet komuna jonë për mirëmbajtjen e shkollave për pastërtinë, për higjienën e shkollave?

Mbledhja mbaroi në orën 15:00.

Procesmbajtësi
Zijadin Gashi

Kryesuesi i Kuvendit
Sami Hamiti, ecc. i dipl.